



Crna Gora / Mali i Zi
Opština Ulcinj
Komuna e Ulqinit
Kabinet Predsjednika
Kabineti i Kryetarit



Crna Gora - Mali i Zi
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit

Samjena - Franjeva		17.12.2024	
Original	Nes Orig	Serijski Broj	Prilog - Dodatak
02-040/24-598		/1	

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi
tel: +382 30 412 050
E-mail: kabinet@ul-gov.me

Nr./Br. 01-040/24-1873/2

Ulqin/Ulcinj, 17.12.2024.god. vit

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT-SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ
Kryteres së Kuvendit / Predsjednici Skupštine

KËTU/OVDJE

E nderuara/Poštovana,

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 alinea 2 Ligjit për vetqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 – Vendimi i GjK MZ i 85/2022 – përmirësimi i Vendimit GjK MZ) dhe nenit 65 të Statutit të Komunës ("Fleta zyrtare e MZ – Regulloret komunale", nr. 48/2019 dhe 05/2024), në shtojcë ju dërgojmë Propozim Vendimin për dhënien e pëlqimit në Programin e punës dhe financiar për SHPK „ Mozhura „, 2025.

Raportuesi i këtij Vendimi në Kuvend do të jetë Sekretari për veprimtari komunale dhe banësore.

Plotësimi i materialit do bëhet nga sekretariati që e ka sjellë vendimin.

Na osnovu člana 58 stav 1 alinea 2 Zakona o lokalnoj samoupravi („Službeni list CG“, br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 – Odluka US CG i 85/2022 – Ispravka Odluke US CG) 65 Statuta Opštine („Službeni list CG – Opštinski propisi“, br. 48/2019 i 5/2024), u prilogu Vam dostavljamo Predlog Odluke o davanju saglasnosti na Program rada i finansijski plan doo „ Mozhura „, za 2025. Izvjestilac ove odluke u Skupštini biće Sekretar za komunalne i stambene djelatnosti.

Dopuna materijala će biti od strane sekretarijata koji je donio odluku.

Me respekt/S poštovanjem,

Za Kryetari/Predsjednik
Genci Nimanbegu

CRNA GORA
MALI I ZI
OPŠTINA ULCINJ
KOMUNA E ULQINIT

Sekretarijat za komunalne i stambene djelatnosti
Sekretariati për veprimtari komunale dhe banesoree



Crna Gora - Mali i Zi
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit

Prilazno - Prilazno	16.12.2024					
Org, ed	Nos, Org	Red, Number	Prav, Pashkat	Vrijed	Vlera	
01-040/24-1873/1						

Br./ Nr: 06 – 082/24-1001/2

Ulcinj, 16.12.2024.g./v.

ZA: KABINET PREDSDJEDNIKA OPŠTINE ULCINJ

Poštovani,

U prilogu dostavljamo vam Odluke o davanju saglasnosti na Program rada i finansijski plan doo. "Možura" za 2025.godine, broj 3394/24 od 12.12.2024.godine. kao i tekst Program rada i finansijski plan doo. "Možura" za 2025.godinu, broj 3394/24 od 12.12.2024.godine.

Molimo Vas da, ukoliko ste saglasni sa tekstom istog Predloga, u skladu sa vašim ovlašćenjima dostavite Skupštini Opštine na razmatranje i odlučivanje.

Izvjestilac po predlogu odluke će biti sekretar ovog sekretarijata.

S'poštovanjem,

Obrađivač,
Jehona Čoba, samost. savjet. III
Za pravne poslove.

SEKRETAR
Leart Taipi dipl.prav.



Propozim

Në bazë të nenit 26,paragrafi 1,dhe neni 29,paragrafi 2,pika7. Të Ligjit për veprimtari komunale (“Faqa zyrtare e Malit të Zi”,nr.55/16,74/16,2/18,66/19,40/19 dhe 140/22),neni 38,paragrafi 1,pika 23.i Ligjit për vetëqeverisjen Lokale(“Faqa zyrtare e Malit të Zi”,nr.2/18,34/19 dhe 38/20),neni 58,paragrafi 1pika 2 dhe 24 e Statutit të komunës së Ulqinit(Faqa zyrtare e Malit të Zi – Rregulloret e Komunës”,nr 48/19),Kuvendi i Komunës së Ulqinit,në sencën e mbajtur më _____2024,miratoi

VENDIMIN

Për dhënien e pëlqimit për Programin e punës dhe planin financiar

Së firmës me përgjegjësi të limituar “Mozhura” për vitin 2025.

Neni 1.

Miratohet Programi i punës dhe plani financiare së firmës me përgjegjësi të limituar „Mozhura“ për vitin 2025, me numër 3394/24,datë 12.12.2024.

Neni 2.

Ky Vendim hynë në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Fletën zyrtare të Malit të Zi – rregulloret komunale“.

Numri:02-

Ulqin,

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

KRYETARJA

Ivana Popović

Baza ligjore për miratimin e këtij vendimi gjendet në dispozitën e nenit 26 paragrafi 1 pika 3 dhe 4 të Ligjit për Veprimtaritë Komunale (Faqa Zyrtare e Malit të Zi“,nr 55/16,74/16,2/18,66/19,40/19 dhe 140/22) ku përcaktohet ndër të tjera se raportin e punës për realizimin e programit të punës me bilancin,operatori i shërbimeve komunale është i detyruar t ia paraqesë organit kompetent të njësisë së vetëqeverisjes lokale më së voni deri më 31 mars të vitit aktual,për vitin paraprak,dhe se kuvendi i njësisë së Vetëqeverisjes lokale duhet të dorëzojë raportin vjetor nga paragrafi 3 i këtij neni,miratohet jo më vonë se qershori 30 të vitit aktual,për vitin paraprak,ndërsa neni 29 paragrafi 2 pika 7 parashikon se realizimi i interesit publik bëhet me miratimin e raportit vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale në përputhje me nenin 26.të këtij ligji.

Neni 38 paragrafi 1 pika 23 e Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (Faqa Zyrtare e Malit të Zi” nr. 2/18,34/19 dhe 38/20) përcakton se Kuvendi shqyrton dhe miraton raportin për punën e kryetarit dhe të komunës dhe punën e autoriteteve dhe shërbimeve nga neni 69 i këtij ligji,ndërsa neni 58,paragrafi 1.pika 2 dhe 24 i Statutit të Komunës së Ulqinit (Faqa Zyrtare e Malit të Zi – rregulloret komunale”,nr.48/19), parasheh që Kuvendi i Komunës miraton rregullore dhe akte tjera të përgjithshme si dhe shqyrton raportin e punës së shërbimeve publike të themeluar nga Komuna.

Duke u bazuar më sipër,i propozohet Kuvendit te sjellë Vendimin për dhënien e pëlqimit të Programit të punës dhe planit financiar për vitin 2025.të firmës me përgjegjësi të limituar “Mozhura”, me numër 3394/24 të datës 12.12.2024.

P ë r p u n e s

Sekretariati për veprimtari komunale dhe banesore



Broj: 3161/24

Datum: 22.11.2024. godine.

**Utvrđeni predlog Programa rada sa finansijskim planom „Možura“ d.o.o
Bar za 2025. godinu.**

Na XVII sjednici VI saziva Odbora direktora „Možura“ d.o.o Bar, održanoj 22.11.2024. godine, Odbor direktora je razmatrao dostavljeni predlog Programa rada sa finansijskim planom „Možura“ d.o.o Bar za 2025. godinu.

Članovi odbora direktora, nakon rasprave dali su saglasnost na predloženi Program rada Društva za 2025. godinu.

Shodno članu 17. Statuta „Možura“ d.o.o Bar, broj 1629/23 od 11.08.2023. godine, Odbor direktora Skupštini Društva dostavlja utvrđeni predlog Programa rada sa finansijskim planom „Možura“ d.o.o Bar za 2025. godinu.

Predsjednik odbora direktora
Savo Đurasić



**PROGRAMI I PUNËS
ME PLANIN FINANCIAR
" MOZHURA" sh.p.k. TIVAR
PËR VITIN 2025**



Tivar, nëntor 2024

P Ë R M B A J T J A

I BAZAT PËR HARTIMIN E PLANIT DHE PROGRAMIT TË PUNËS	3
II HYRJE DHE DREJTIMET STRATEGJIKE TË MENAXH. TË MBETJEVE	3
III TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR DEPONINË	6
IV PLANI I ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM TË DEP. SANITARE MOZHURA	10
V PLANI OPERATIV I PUNËS	16
VI PROGRAMI OPERATIV I PUNËS PËR VITIN 2025	18
VII RESURSET E “MOZHURA” sh.p.k. - PAJISJA MATERIALE DHE TEKNIKE	20
VIII PLAN FINANCIAR	22
IX DREJT. E FUNKCION. NË TË ARDH.-MISIONI, VIZIONI DHE QËLLIMET	25
X PËRFUNDIM	27

Bashkëngjitur:

Vendim i Kuvendit të Shoqërisë



Broj: /24

Datum: 29.11.2024.godine

Na osnovu člana 16. Statuta “Možura” d.o.o Bar, broj 1629/23 od 11.08.2023. godine, Skupština društva je na XII sjednici, razmatrajući predlog Odbora direktora u “Možura” d.o.o Bar, dana 29.11.2024. godine, donijela sledeću

O D L U K U

Utvrđuje se kao konačan predlog godišnjeg Programa rada sa finansijskim planom za 2025. godinu, predložen i dostavljen od strane Odbora direktora u Društvu od 22.11.2024. godine.

Utvrđeni predlog godišnjeg Programa rada sa finansijskim planom za 2025. godinu, dostavlja se Skupštinama Opština Bar i Ulcinj na usvajanje.

Predsjednik Skupštine društva
Dušan Raičević



I BAZAT PËR HARTIMIN E PLANIT DHE PROGRAMIT TË PUNËS

Plani i punës i “Mozhura” sh.p.k është dokumenti bazë i punës për realizimin e aktiviteteve të kompanisë në vitin 2024.

Gjatë hartimit të planit të punës është kujdesur që të respektohen normat ligjore dhe rregulloret pozitive për mënyrat e funksionimit të suksesshëm të menaxhimit të kompanisë.

Plani i punës përfshin të gjitha sferat e veprimtarisë për vitin e ardhshëm afarist. Një theks i veçantë i kushtohet realizimit të projekteve zhvillimore që synojnë krijimin e bazës për funksionim më të mirë dhe më të suksesshëm në vitet e ardhshme të funksionimit të deponisë, në përputhje me direktivat e BE-së dhe ligjet për mbrojtjen e mjedisit.

II HYRJE DHE DREJTIMET STRATEGJIKE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Kompania "Mozhura" sh.p.k Tivar është regjistruar në Regjistrin Qendror të Gjykatës Ekonomike të Malit të Zi më 04.11.2008., me numër 5-0502603/005 dhe aktiviteti kryesor i Shoqërisë është:

38.00 -grumbullimi, përpunimi dhe deponimi i mbetjeve, ripërdorimi i materialeve të mbetjeve

38.11 -grumbullimi i mbetjeve jo të rrezikshme

38.12 -grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme

38.21 -përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të padëmshme

38.22 -përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme

38.32 -riciklimi i mbetjeve të renditura

39.00 - Pastrimi i mjedisit dhe aktivitete të tjera që lidhen me menaxhimin e mbetjeve.

Deponia sanitare e Mozhurës është ndërtuar në përputhje të plotë me Ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Direktivën e BE-së nr. 99/31/EC, 06/12EC, 08/98EZ

Me miratimin e Ligjit për menaxhimin e mbetjeve, FI. Zyrtare MZ, nr.34/2024, datë 12.04.2024, Mali i Zi vendosi të organizojë grumbullimin, deponimin e përkohshëm, transportimin, përpunimin dhe deponimin duke respektuar parimet:

- **e zhvillimit të qëndrueshëm**, i cili siguron përdorim më efikas të resurseve, zvogëlimin e sasisë së mbetjeve dhe trajtimin e mbetjeve në mënyrë që të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm;
- **e afërsisë dhe menaxhimit rajonal të mbetjeve**, me qëllim që mbetjet të përpunohen sa më afër vendit të krijimit në përputhje me arsyetimin ekonomik të zgjedhjes së lokacionit, ndërsa menaxhimi rajonal i mbetjeve sigurohet nga zhvillimi dhe zbatimi i planeve strategjike rajonale bazuar në politika shtetërore;
- **e masave paraprake, respektivisht parandaluese, duke marrë masa për të parandaluar ndikimet negative në mjedis dhe shëndetin e njerëzve, edhe në mungesë të të dhënave shkencore dhe profesionale;**

- **“ndotësi paguan”**, sipas të cilit prodhuesi i mbetjeve përballon kostot e menaxhimit të mbetjeve dhe veprimeve parandaluese dhe kostot e masave të sanimit, për shkak të ndikimeve negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut;
- **hierarkinë**, e cila siguron respektimin e renditjes së prioriteteve në parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve, përkatësisht:
 - parandalimi;
 - përgatitje për ripërdorim;
 - riciklimi;
 - metoda të tjera të përpunimit, dhe
 - trajtimi i mbetjeve.

- **grumbullimi i ndarë i mbetjeve dhe ndalimi i përzierjes së tyre me mbetje të tjera ose materiale të tjera** kur është e nevojshme për të përmbushur qëllimet dhe parimet e këtij ligji dhe hierarkinë e mbetjeve, si dhe për të lehtësuar dhe përmirësuar përgatitjen për ripërdorim, riciklim ose procedura të tjera të përpunimit;
- që mbetjet ose materialet e përfuara prej tyre nuk përfaqësojnë një potencial rreziku më të madh në rast riciklimi sesa lëndët e para primare të krahasueshme ose produktet nga lëndët e para primare

- **Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit** sipas së cilës çdo person fizik ose juridik që zhvillon, prodhon, përpunon, ripërpunon, shet ose importon produkte në mënyrë profesionale mban përgjegjësi për menaxhimin e mbetjeve të mbetura pas përdorimit të atyre produkteve, si dhe përgjegjësi financiare për këto aktivitete.
- **Prodhuesi që vendos në tregun e Malit të Zi pajisje elektrike dhe elektronike, automjete, bateri dhe akumulatorë, goma, ambalazhe, produkte plastike për një përdorim dhe pajisje peshkimi që përmbajnë plastikë, është i detyruar të krijojë programin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe të sigurojë:**

-grumbullimi i veçantë i mbetjeve të krijuara nga këto produkte si mbetje komunale dhe të grumbulluara nga persona të regjistruar në regjistrin e grumbulluesve të mbeturinave komunale;

-grumbullimi i ndarë i mbetjeve që dalin nga këto produkte si mbetje komunale që nuk janë mbetje komunale nga amvisëritë ose si mbetje që nuk janë mbetje komunale;

-përpunimi i mbetjeve të grumbulluara që rezultojnë nga produktet e përmendura;

-përmbushjen e qëllimeve të grumbullimit të veçantë, përgatitjes për ripërdorim, riciklimit ose procedurave të tjera të përpunimit të mbetjeve që rrjedhin nga produkti sipas sistemit të specifikuar të përgjegjësisë së zgjeruar.

- **Prodhuesi i produkteve që përfshihen në sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar është i detyruar të zbatojë detyrimet nga programi i përgjegjësisë së zgjeruar në atë mënyrë që:**

-organizon në mënyrë të pavarur sistemin e mbledhjes, grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve;

-së bashku me prodhues tjetër organizon sistem të organizuar kolektiv të mbledhjes, grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve nëpërmjet një kompanie të veçantë;

-bashkohet me sistemin e vendosur kolektiv të mbledhjes, grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve në përputhje me ligjin dhe lidh kontratë me menaxhuesin e sistemit të organizuar kolektiv.

Mbetje është çdo substancë ose objekt që poseduesi e hedh, synon ta hedh ose duhet ta hedhë në përputhje me ligjin.

Llojet e mbetjeve janë:

- Mbetjet komunale - mbetjet e krijuara në amvisëri (mbetjet shtëpiake), si dhe mbetjet e krijuara nga kryerja e aktiviteteve të caktuara të cilët për nga natyra dhe përbërja e tyre janë të ngjashme me mbetjet shtëpiake
- Mbetjet komerciale - mbetjet e krijuara nga subjektet afariste, institucione dhe të tjera organizata, të cilat janë të merren plotësisht ose pjesërisht në tregti, veprimtari shërbimi, punë në zyrë, sport, rekreacion ose argëtim, duke mos përfshirë mbetjet shtëpiake
- Mbetjet industriale - mbetjet e krijuara nga çdo objekt industrial, si dhe në lokacionet ku ndodhen, dhe të cilat ndryshojnë nga mbetjet komunale për nga përbërja dhe karakteristikat e tyre.

Në varësi të karakteristikave të mbetjeve, mbetjet mund të ndahen në:

- Të rrezikshme - çdo mbetje që përmban substanca që kanë një nga vetitë e mëposhtme: shpërthyes, reaktivitet, acarim, dëmtim, toksicitet, infektivitet, kancerogjenitet, mutagjenitet, etj.
- Jo të rrezikshme – mbetje që nuk kanë asnjë nga vetitë e mbetjeve të rrezikshme;
- Mbetjet inerte – janë mbetje jo të rrezikshme, të cilat nuk i nënshtrohen ndryshimeve të mëdhaja fizike, kimike ose biologjike. Mbetjet inerte nuk janë të tretshme, të djegshme, reaktive në mënyra të ndryshme ose të dekompozueshme.

Menaxhimi i mbetjeve kryhet me grumbullim të veçantë të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit në mënyrë të tillë që:

- deri në vitin 2030, përgatitja për ripërdorimin dhe riciklimin e materialeve të mbetjeve, si letra, metali, plastika dhe qelqi, nga amvisëria dhe burime të tjera në të cilat rrjedhat e mbetjeve janë të ngjashme me rrjedhat e mbetjeve nga shtëpia, të jetë të paktën 50% e masës totale të mbetjeve të grumbulluara;
- deri në vitin 2030, përgatitja për ripërdorim, riciklim dhe metoda të tjera të përpunimit të materialit, duke përfshirë procedurat e mbushjes në të cilat mbetjet përdoren si zëvendësim për materiale të tjera, të mbetjeve ndërtime jo të rrezikshme, duke përjashtuar materialet nga natyra të përcaktuara me numrin 17 05 04 në listën e mbetjeve, të jetë të paktën 70% e masës së mbetjeve të grumbulluara.

Sipas nenit 84 të Ligjit për Menaxhimin e Mbetjeve, nga sasia totale e mbetjeve komunale të prodhuara, sasia e mbetjeve komunale të përpunuara të deponuara duhet të reduktohet në 10% ose më pak deri në vitin 2040.

Plani shtetëror i menaxhimit të mbetjeve është dokumenti bazë, i cili përcakton qëllimet afatgjata të menaxhimit të mbetjeve dhe përcakton kushtet për menaxhim racional dhe të qëndrueshëm të mbetjeve në Mal të Zi. Ai ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale të menaxhimit të mbetjeve. Plani përmban masat që duhet të ndërmerren për të siguruar kushtet më të mira për përgatitjen e mbetjeve për ripërdorim, riciklim dhe asgjësim, në një mënyrë të pranueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.

Mali i Zi është i ndarë në njësi të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht komuna. Ndarja rajonale e vendit është paraqitur në Planin Hapësinor të Malit të Zi deri në vitin 2040 (nga viti 2023) në qendra rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Sipas Planit Shtetëror të Menaxhimit të Mbetjeve 2023-2028, si dhe Planit Hapësinor të Malit të Zi deri në vitin 2040, Tivari është paraparë si qendër e rajonit bregdetar.

III TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR DEPONINË

Vendim për Hartimin e Projektit Urbanistik “Deponia Sanitare Ndërkomunale Mozhura” Nr.030-119, datë 07.08.2005, është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Tivarit në seancën e mbajtur më 08.07.2005, dhe bazën ligjore për marrjen e këtij vendimi e përmban neni 31 i Ligjit për planifikim dhe rregullim hapësinor (“Fletorja Zyrtare e MZ”, nr. 28/05).

Objektivat e hartimit të Projektit Urbanistik janë në përputhje me Masterplanin Strategjik në nivel shtetëror, interesin e shprehur investues dhe programet zhvillimore të Komunës së Tivarit, (të cilët u shqyrtuan përmes Studimit të Fizibilitetit për ndërtimin dhe funksionimin e deponisë sanitare rajonale "Mozhura"), të përpunohet lokacioni në fjalë dhe të krijohet baza planifikuese për realizimin e mëtejshëm të planit.

Kufiri i deponisë sanitare përcaktohet me Vendim për Hartimin e Projektit Urbanistik dhe Detyrës Programore. Lokacioni është pjesë e parcelës kat. 2416/1 KO Kunje. sipërfaqja e parcelës kadastrale është përafërsisht 22.5 ha dhe përfshihet nga Projekti Urbanistik "Deponia Sanitare Ndërkomunale Mozhura". Kuvendi i Komunës së Tivarit mbajti seancën e XX-të më 29.01.2010. miratoi Projektin Urbanistik “Deponia Sanitare Ndërkomunale Mozhura”. Vendimi për miratimin e projektit urbanistik është publikuar në “Fletoren Zyrtare të MZ – dispozitat komunale”, nr.6/10, datë 08.02.2010.

Qëllimi kryesor i deponisë sanitare është deponimi i rregullt i mbetjeve komunale, të cilat prodhohen në territoret e komunave të Tivarit dhe Ulqinit. Si pjesë e zgjidhjes afatgjatë të çështjes së deponimit të mbetjeve komunale, lokacioni i Mozhurës u zgjodh si zgjidhja më e mirë për ndërtimin e deponisë sanitare ndërkomunale.

Deponia sanitare e Mozhurës është ndërtuar në përputhje të plotë me Ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Direktivën e BE-së nr. 99/31/EC, 06/12EC, 08/98EC. Teknologjia e punës paraqet një metodë të deponimit përfundimtar të mbetjeve komunale, në të cilën mbetjet komunale hidhen në mënyrë të kontrolluar në një terren të përgatitur teknikisht dhe teknologjikisht të izoluar me barijera të shumta mbrojtëse.

Lokacioni i deponisë gjendet përballë gjirit Hladna, në territorin e komunës së Tivarit, përballë hyrjes në tunelin Belveder, i cili është kufiri ndërmjet komunave të Tivarit dhe Ulqinit. Peizazhi natyror përbëhet nga e ashtuquajtura kategori garigë, në lartësinë 245-295 m mbi nivelin e detit, të cilat ekzistojnë ende në pjesën e pandërtuar, rreth përrenjve dhe kodrave. Deponia është ndërtuar në një kodër, afër rrugës Tivar – Ulqin, me pamje nga deti. Lokacioni ndodhet në terrene jo të rrafshta me përbërje gëlqerore. Nga rruga kryesore deri te lokacioni ka një rrugë akses të asfaltuar me gjatësi rreth 2 km. Në zonën e lokacionit dhe në afërsi të tij nuk ka zona të mbrojtura kur bëhet fjalë për pasuritë natyrore dhe kulturore. Për shkak të konfigurimit të terrenit në zonën përreth lokacionit të deponisë, nuk ka ndërtesa banimi apo tregtare në një distancë prej rreth 850 m. Lokacioni është rreth 1.500 m larg nga deti me vijë ajrore.

Sipas nevojave dhe planit të aktiviteteve të parapara për ndërtimin dhe funksionimin e vetë deponisë së Mozhurës, kryetarët e komunave së Tivarit dhe Ulqinit më 31.10.2008. kanë nënshkruar Marrëveshjen për themelimin e kompanisë "Mozhura" sh.p.k, për menaxhimin e deponisë sanitare rajonale të Mozhurës.

Në vitin 2023, kompania bleu nga fondet e veta një truall me sipërfaqe 44.430 m², i cili është ngjitur me deponinë ekzistuese dhe që do të përdoret për nevojat e zgjerimit të kapacitetit të deponisë dhe zbatimin e aktivitete të reja me qëllim të trajtimit më të mirë të mbetjeve të deponuara në Mozhur.

Pjesëmarrja e Komunës së Tivarit në kompaninë "Mozhura" sh.p.k. është 65%, ndërsa Komuna e Ulqinit ka 35%. Përqindja e pjesëmarrjes është përcaktuar në bazë të treguesve të sasisë së mbetjeve komunale nga këto dy komuna dhe lokacionit të vetë deponisë.



Foto 1: Deponia Mozhura

Është ndërtuar trupi i deponisë, i përbërë nga 4 kaseta (vaska) teknologjike të ndara dhe të pavarura. Dimensionet e trupit të deponisë janë 305 x 165 m. Lartësia maksimale është 25.0 m.

Kapaciteti total i projektuar i deponisë është **1.056.036,21m³**.


Kapaciteti i përmendur në deponi përbëhet nga katër faza të funksionimit të deponisë:

Faza I 394.606,70m³;

Faza II 293.601,01m³;

Faza III 223.142,66m³;

Faza IV 144.685,85m³.



Grafiku 1: Pasqyra e kapacitetit dhe funksionimit të deponisë përmes fazave IV të shprehura në m³

Kapaciteti i deponisë në nëntor 2023, pas 12 vitesh funksionim, është 850.000 m³, që paraqet 85% të kapacitetit total të planifikuar të deponisë, që është 1.056.036,21 m³. Duke qenë se ngjeshja e mbetjeve u krye shumë më tepër se sa ishte planifikuar, deri më tani janë depozituar mbi 947.000t. Pritet që kapacitetet totale të plotësohen deri në fund të vitit 2026, nëse dinamika e mbetjeve të deponuara është në nivelin e viteve të mëparshme.



Grafiku 2: Pasqyra e zënies së kapacitetit të vaskave sanitare e shprehur në përqindje

Duke pasur parasysh se jetëgjatësia e deponisë është dukshëm shkurtuar, se më shumë se 85% e kapacitetit është shfrytëzuar, duke qenë se të gjitha komunat bregdetare përveç Herceg Novi hedhin mbetjet në Mozhurë, prioriteti i Kompanisë do të jetë intesifikimi i aktiviteteve për zgjerimin e kapaciteteve duke ndërtuar vaska të reja sanitare.

IV PLANI I DREJTIMEVE TË ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM TË DEPONISË SANITARE MOZHURA

Plani i punës përcakton udhëzimet në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të fukcionimit të Kompanisë, me theks në zgjerimin e kapacitetit të deponisë dhe zhvillimin e veprimtarive të reja.

Krahas ushtrimit të veprimtarisë bazë, e cili ka të bëjë me deponimin cilësor të mbetjeve komunale dhe ndërtimin e vaskave të reja sanitare, projekti që do të shënojë vitin 2025 është ndërtimi dhe vënia në punë e një centrali të deponisë për bio gaz, i pari i këtij lloji në këtë pjesë të Ballkanit. Përgatitja e dokumentacionit projektues dhe teknik do të vazhdohet në mënyrë aktive për të gjitha projektet realizimi i të cilave është planifikuar në Programin e Punës. Do të punohet për përmirësimin e bashkëpunimit me partnerët e huaj dhe aplikimin në fondet vendase dhe të huaja, për të fituar sa më shumë grante për realizimin e aktiviteteve, të gjitha me synimin për një menaxhim më të mirë të mbetjeve.

Projektet e planifikuara dhe aktivitetet në implementim

Ndërtimi i vaskave të reja sanitare

Duke qenë se të gjitha komunat bregdetare, përveç Herceg Novit, i hedhin mbetjet e tyre në deponinë “Mozhura”, si dhe palët e treta me të cilët kemi nënshkruar kontrata, si dhe fakti që nga fillimi i funksionimit janë deponuar më shumë se 940,000 t, pritet që kapacitetet totale të plotësohen deri në fund të vitit 2026, me dinamikën aktuale të deponimit të mbetjeve, e cila ka qenë e vazhdueshme gjatë viteve të fundit të funksionimit.

Duke marrë parasysh këtë situatë, ndërtimi i vaskave të reja sanitare është i një rëndësie kyçe për vazhdimin e ekzistencës së deponisë dhe mundësinë e deponimit sanitar të mbetjeve në komunat e rajonit bregdetar. Menaxhmenti i Mozhurës ka punuar në mënyrë aktive që nga viti 2021 për të krijuar kushte dhe për të ofruar mbështetje financiare për fillimin e ndërtimit të vaskave të reja.

Ndërtimi i vaskave të reja sanitare në deponinë e Mozhurës është paraparë me listën e projekteve prioritare të Qeverisë së Malit të Zi, Planin Shtetëror të Menaxhimit të Mbetjeve, Planin Zhvillimor Strategjik të Komunës së Tivarit dhe programet e punës së “Mozhura” sh.p.k. Tivar

Janë punuar tri zgjidhje konceptuale për zgjerimin e mundshëm të kapacitetit të Deponisë dhe ndërtimin e vaskave të reja sanitare.

Në vitin 2023, është bërë zgjidhja konceptuale për ndërtimin e vaskave të reja sanitare, u bë elaborati gjeodezik dhe gjeomekanik në pjesën që i afrohet vaskave ekzistuese në anën juglindore. Zgjidhja konceptuale konsideronte dy opsione: e para - që do të përfshinte tokë

private me një sipërfaqe totale rreth 46 000 m² dhe e dyta - një sipërfaqe prej 80 000 m², e cila do të përbëhej nga tokë private dhe shtetërore.

Nëse zgjerimi kryhet në tokë në pronësi të Mozurës, kapacitetet e planifikuara janë të mjaftueshme për 8-10 vitet e ardhshme të deponimit të mbetjeve. Për të zgjidhur në mënyrë të përhershme çështjen e deponimit të mbetjeve në rajonin bregdetar për 20 vitet e ardhshme, është e nevojshme të caktohet edhe një pjesë e tokës shtetërore.

Me sigurimin e pronësisë mbi tokën u plotësuan kushtet që ajo të shpallej tokë me interes publik, në mënyrë që të fillonin aktivitetet për ndërtimin e vaskave të reja sanitare.

Aktualisht, çështja për ridestinimin e kulturës së tokës është në procedurë me Administratën e Pasurive të Paluajtshme dhe Ministrinë e Bujqësisë, pas së cilës presim të marrim vendimin me të cilin zgjerimi i objekteve sanitare do të shpallet me interes publik, në përputhje me Ligjin.

Nëse marrim parasysh faktin se për zhvillimin e projektit dhe punimeve të ndërtimit duhen të paktën 24 muaj dhe se kapacitetet ekzistuese janë të mjaftueshme deri në fund të vitit 2026, është evidente se ky është momenti i fundit për të filluar zbatimin e projekt kyç ekologjik në rajonin jugor të Malit të Zi.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Ekologjisë përmes PPF-së, është duke u përgatitur Studimi i Fizibilitetit dhe Projekti Ideor për zgjerimin e kapaciteteve të deponisë së Mozurës, i cili financohet nga Bashkimi Evropian në vlerë prej 150,000€.

Ministrisë kompetente i është dorëzuar kërkesë për dhënien e kushteve urbanistike-teknike për zgjerimin e kapaciteteve dhe realizimin e projekteve tjera të planifikuara. Presim që përfaqësuesit e institucioneve kompetente shtetërore të njohin rëndësinë e këtij projekti shtetëror, si dhe të na japin mbështetjen e nevojshme.



Foto 2: Lokacioni i planifikuar për ndërtimin e vaskave të reja sanitare (privat dhe shtetëror)

Ndërtimi i sistemit për prodhimin e energjisë elektrike nga gasi i deponisë

Impianti i grumbullimit, transportit dhe djegies së gazit të deponisë në Mozhurë u ndërtua në vitin 2016 dhe që atëherë është në funksion 24 orë në ditë, 365 ditë në vit. Matjet e rregullta kanë treguar se gasi është i cilësisë së mirë dhe se disponohet në sasi të mjaftueshme dhe se prej tij mund të krijohet një vlerë e re.

Gjatë vitit 2022 është përgatitur Studimi i Fizibilitetit për projektin e shndërrimit të energjisë së biogazit në energji elektrike. Sasitë e përmendura treguan arsyetimin e ndërtimit të centralit elektrik. Në bazë të treguesve dhe parametrave nga Studimi, filloi në mënyrë aktive përgatitja e dokumentacionit të mëtejshëm projektues dhe marrja e lejeve për të ndërtuar centralin e parë të këtij lloji në këtë pjesë të Evropës në Mozhurë.

Gjatë vitit 2023 përfundoi detyra projektuese, filloi përgatitja e projektit kryesor, i cili u përfundua dhe u revidua në gusht 2024.

Në nëntor 2024, tenderi përfundoi dhe u zgjodh kontraktori. Afati i përfundimit të punimeve është 9 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Pas ndërtimit, ka një periudhë prove të përcaktuara nga CEDIS-i në përputhje me kushtet e përcaktuara.

Me zbatimin e fazës II të projektit të konvertimit të gazit të deponisë, do të krijohet një vlerë e re në formën e një burimi energjie të rinovueshme, që ka një vlerë ekonomike.

Kompania jonë aplikoi dhe me mbështetjen e Eko Fondit të Malit të Zi, është financuar hartimi dhe revidimi i Projektit Kryesor të centralit elektrik në shumën prej 50.000 euro.

Detyrim i "Mozhura" sh.p.k.Tivar, është të menaxhojë deponinë edhe për 30 vite të tjera pas mbylljes së saj, d.m.th. për sa kohë prodhohet biogazi, duke krijuar kështu parakushtet që

edhe pas mbylljes, kompania të gjenerojë të ardhura nga energjia elektrike e shpërndarë duke konvertuar energjinë e biogazit.

Për sa i përket aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e vaskave të reja ku do të prodhohen sasi të reja gazi, ndërtimi i centralit në Mozhurë paraqet një investim të mirë me një periudhë të shkurtër kthimi të fondeve të investuara dhe një periudhë të gjatë shfrytëzimi.

Projekti i ndërtimit të centralit kap vlerën prej 1.4 milionë euro dhe do të realizohet në bashkëpunim me Qendrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Republikës së Sllovenisë, e cila si partner në projekt do të marrë pjesë me rreth 50% të mjeteve. Gjysma tjetër do të financohet nga buxheti i deponisë së Mozhurës. Procedura e tenderit ka përfunduar dhe është zgjedhur ofertuesi më i favorshëm. Centrali Možura do të vihet në punë në vitin 2025 si i pari i këtij lloji në këtë pjesë të Ballkanit dhe Evropës.



Foto 3: Impianti për djegjen e gazit të deponisë në Deponinë Mozhura




Foto 4: Lokacioni i planifikuar për centralin me biogaz

Siç përcaktohet në Programin e Punës për vitin 2025, zbatimi i dy projekteve kyç është ndërtimi i centralit me gaz të deponisë dhe hartimi i dokumentacionit projektues për zgjerimin e kapacitetit të deponisë dhe fillimi i ndërtimit të vaskave të reja sanitare.

Paralelisht me projektin më të rëndësishëm ekologjik të rajonit bregdetar, në Mozhurë, krahas ndërtimit të vaskave sanitare, do të ndërmerren hapa për zbatimin e një sërë projektesh të rëndësishme ekologjike, infrastrukurore që lidhen me:

- Ndërtimi i Qendrës për Selektim dhe Kompostim

Projekti i qendrës për seleksionimin, kompostimin dhe trajtimin e mbeturinave ndërtimore është në fazën e Studimit të Fizibilitetit sipas tenderit të Drejtorisë për Punë Publike dhe në bazë të detyrës projektuese të Sekretariatit për Planifikim Hapësinor të Komunës së Tivarit, përfunduar në fund të vitit 2015.

Gjatë vitit 2019 është kryer studim i ri, i financuar nga BE-ja, parashikohet sasia prej 16.67% e mbetjeve, të cilat do të seleksionohen në të gjithë impiantin për seleksionim, e cila, siç ka treguar praktika, do të ishte një përqindje më e vogël se sa ajo që përmendet, nëpërmjet studimit Qendra e Kompostimit, si qendra e përpunimit të mbetjeve (MBO), do të vendosej në të hapur dhe do të kryhej përpunim, i cili do të prodhonte shumë ndikim negativ në përhapjen e aromave të pakëndshme. Gjithashtu, pas “përpunimit”, të gjitha mbetjet e kompostimit do të hidheshin në Deponinë, herë si pjesë mbuluese, herë përmes materialit, i cili kthehet në trupin e deponisë.

Është në proces rishikimi i Studimit për pjesën që ka të bëjë me kompostimin, i cili po realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Ekologjisë, krahas programit PPF si donacion nga Bashkimi Evropian. Në kuadër të PU-së ekzistuese Mozhura është planifikuar ndërtimi i qendrës për seleksionim dhe kompostim dhe pritet që të sigurohen mjete në bashkëpunim me BERZH-in.

- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave kulluese të vaskave të reja sanitare

Instituti i Ndërtimtarisë "IG" Banja Luka, i cili ishte projektuesi kryesor për ndërtimin e deponisë, ka bërë studimin e fizibiliteti dhe përzgjedhjen e teknologjisë më të mirë për trajtimin e kullimit me një zgjidhje konceptuale të teknologjisë së zgjedhur. Bazuar në analizat e detajuara me shumë kriterë dhe vlerësimet krahasuese, miratimi i procedurës së osmozës së kundërt (RO) u propozua si teknologjia më e mirë për pastrimin e kullimit në deponinë e Mozhurës. Duke qenë se kapacitetet e deponisë ekzistues janë të mjaftueshme deri në fund të vitit 2026, ndërtimi i impiantit për kapacitetet ekzistuese nuk është ekonomikisht i arsyeshëm, por është planifikuar paralelisht me ndërtimin e vaskave të reja sanitare. BERZH është gati të mbështesë financiarisht ndërtimin e sistemit për vaska të reja sanitare që do të ndërtohen në periudhën e ardhshme.

- Ndërtimi i qendrës për grumbullimin, sortimin, ruajtjen dhe përpunimin e mbetjeve të gomave

Në zonën e deponisë së Mozhurës ka hapësirë të mjaftueshme ku mundësohet organizimi i pritjes, klasifikimit, magazinimit dhe përpunimit të gomave të mbetjeve nga të gjithë përdoruesit e shërbimit të rajonit bregdetar. Për këto nevoja është bërë një studim bazë për grumbullimin, klasifikimin, ruajtjen dhe përpunimin e gomave. Për këtë qëllim në deponinë e Mozhurës janë siguruar hapësira prej 10,000 m². Mozhura ka marrë leje për përpunimin e gomave nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit. Duke pasur parasysh se deponia e Livadës në Podgoricë po planifikon ndërtimin e objektit për përpunimin e gomave, dhe se sasia totale e gomave të gjeneruara çdo vit në Mal të Zi nuk është e mjaftueshme për funksionimin e një qendre me kapacitet të plotë, synimi është që Mozhura të jetë qendër rajonale për pranimin e gomave, ku do të kryhej përpunimi primar dhe magazinimi i gomave derisa ato të dërgohen për përpunim të mëtejshëm në qendrën e pranimin në deponinë Livade ose në ndonjë qendër tjetër jashtë Malit të Zi.

-Ndërtimi i oborrit të riciklimit

Në zonat e komunave themeluese të deponisë, Tivarit dhe Ulqinit, edhe pse ka mundësi ligjore, deri më tani nuk është organizuar oborri i riciklimi. Duke marrë parasysh veprimtarinë me të cilën meret Kompania, si dhe zonat e lira brenda parcelës ubranistike të Mozhurës, ne besojmë se një pjesë e saj duhet të caktohet për oborr riciklimi. Sistemi i riciklimit të mbetjeve në vendin tonë nuk ka zënë rrënjë në formën e duhur dhe qytetarët nuk kanë mënyrën më adekuate për të deponuar mbetjet në vendet e caktuara në qendër të qytetit apo në zonat periferike. Ne besojmë se ekzistenca e një oborrit të riciklimit në Mozhurë do të kontribuonte në një nivel më të lartë të riciklimit të mbetjeve në rajonin bregdetar.

Zbatimi i projekteve të përmendura i tejkalon kapacitetet financiare dhe kadrovike të Kompanisë.

Gjatë vitit 2024, menaxhmenti i Kompanisë zhvilloi diskutime aktive me përfaqësues të BERZH-it dhe AFD-së, të cilët shprehën gatishmërinë për të mbështetur financiarisht realizimin e të gjitha projekteve të lartpërmendura me vlerë mbi 20 milionë euro.

Me mbështetjen e komunave themeluese dhe Ministrisë së Ekologjisë presim mbështetjen e institucioneve të tjera shtetërore, në radhë të parë Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Malit të Zi.

V PLANI OPERATIV I PUNËS

Në deponinë sanitare të Mozhurës, mbetjet e ngurta komunale grumbullohen me automjetet e ndërmarrjeve të cilat kanë nënshkruar kontrata për deponimin e mbetjeve me Deponinë. Automjeti që merr lejen e hyrjes shkon në pikën e pranimit, ku bëhet identifikimi i automjetit dhe drejtuesit dhe përcaktohet lloji i mbetjeve. Nëse konstatohet se në automjet ka mbetje, të cilat nuk janë të parapara për deponim në deponinë sanitare, siç përcaktohet në Lejen e Integruar, automjeti duhet të kthehet. Në pikën e pranimit ka një peshore elektronike për automjete që përcakton peshën bruto të automjetit. Pas peshimit, automjeti me mbetjet drejtohet në vaskën sanitare dhe atë përmes rrugës, shpejtësia maksimale e së cilës është 20 km/h.

Që nga maji i vitit 2024, janë krijuar kushtet që personat juridikë dhe fizikë të deponojnë mbetjet në përputhje me rregullat në fuqi dhe listën e çmimeve, të cilat përcaktojnë llojet e mbetjeve që mund të deponohen në deponinë e Mozhurës.

Dheu dhe gurë të gërmuar - 0,50 €/t

Mbetjet e ndërtimit dhe mbetjet e prishjes (tulla, fraksione betoni, pllaka, qeramika, mbetje të tjera jo të dekompozueshme - **3,00 €/t**

Mbetjet e gjelbra - mbetje nga hortikultura, bujqësia... - **20,00 €/t**

Mbetje të mëdha - kolltukë, dyshekë, tavolina, karrige, lavatriçe... - **20,00 €/t**

Metal – pa pages

Ndalohe rreptësisht deponimi i - mbeturinave të përziera komunale, mbeturinave të pastrimit të ujërave të zeza apo mbeturinave të tjera të depompozueshme që nuk përfshihen në këtë listë çmimesh shërbimi.

Me zgjatjen e Lejes së Integruar të lëshuar më 15.11.2023. nr. 03-UPI-701/6 përfshinte që ne mund të përpunojmë: Mbetje të mëdha, mbetje të përziera nga prishja (mbetje ndërtimi), përzierje të fraksioneve individuale të betonit, tullave, pllakave dhe qeramikës dhe përpunimit të gomave.

Me hapjen e qendrës për pranimin dhe përpunimin e mbetjeve ndërtimore dhe mbetjeve të rrënimin për komunën e Tivarit dhe Ulqinit, në masë të madhe është zgjidhur çështja e këtyre llojeve të mbetjeve.

Nga maji deri në nëntor 2024, qytetarët kanë deponuar 753.2 t dhe subjektet ekonomike 46 488.98 t mbetje.

Personat fizikë:

1. Mbetje të mëdha - 124.1 t,

2. Mbetje të dekompozueshme (mbetje të gjelbra) - 29,54 t.

3. Mbetjet e ndërtimit (përzierjet ose fraksionet individuale të betonit, tullave, pllakave dhe qeramikës) - 430.98 t.

4. Dheu dhe guri - 168,44 t.

5. Metalet - 0,14 t.

Personat juridikë:

1. Mbetje të mëdha - 121,1 t.

2. Mbetje të dekompozueshme (mbetje të gjelbra) - 21,52 t.

3. Mbetjet e ndërtimit (përzierjet ose fraksionet individuale të betonit, tullave, pllakave dhe qeramikës) - 286,44 t.
4. Dheu dhe guri - 46,051,88 t.
5. Metalet - 3,92 t.
6. Gomat - 4,12 t.

Teknologjia e ngjeshjes është jashtëzakonisht e rëndësishme, si për nga trashësia e shtresës, e cila është optimale të jetë 40-50 cm, ashtu edhe për sa i përket numrit të kalimeve të kompaktorit mbi mbetjet komunale. Shkalla e ngjeshjes është një parametër kritik që përcakton jetëgjatësinë e deponisë, prandaj është i nevojshëm përdorimi i kompaktorëve, të cilët punojnë për të arritur dendësi më të madhe të mbetjeve të deponuara, dhe në këtë mënyrë kursejnë hapësirë. Deri më tani, kjo mënyrë vlerësohej të ishte cilësore, siç dëshmohet nga matjet e bëra në deponi.

Mbetjet rikontrollohen në vaskën sanitare, kur ato zbrazen nga automjeti. Pas shkarkimit, automjeti largohet nga zona e vaskës sanitare në zonën e largës së rrotave. Pas largës së rrotave, kthehet në peshoren elektronike, ku mjeti matet pa ngarkesë. Në këtë mënyrë fitohet pesha e mbetjeve të hedhura në vaskën sanitare. Për çdo automjet lëshohet një fletë-dorëzimi - d.m.th çertifikata e sasisë së mbetjeve të hedhura. Mbetjet e paselektuara shpërndahen në vaskë sanitare me buldozer dhe pas kësaj, nëse konstatohet se mbetjet nuk kanë lagështi të mjaftueshme, lagen me ujë dhe ngjeshen me një makinë të posaçme - kompaktorin.

Dendësia mesatare e mbetjeve të ngjeshura, të cilat sillen nga automjetet e shoqërive komunale, është 300-350 kg/m³ dhe dendësia mesatare pas ngjeshjes me kompaktor është parashikuar nga Projekti Kryesor të jetë 800-830 kg/m³.

Shtimi i mbetjeve bëhet deri në lartësinë 3 m dhe më pas mbetjet mbulohen me material inert. Mbulimi duhet të bëhet pothuajse çdo ditë. Pas çdo shtrese prej 3m, është e nevojshme ngritja e biogypave për aspirimin e biogazit të deponisë, si dhe linjat dytësore të gazsjellësit. Funkcionimi i duhur i Deponisë kërkon sigurimin e një sasive të mjaftueshme uji, si për lagjen e mbetjeve komunale, ashtu edhe për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra.

Me mjetet dhe angazhimin e saj, Kompania në vazhdimësi kryen gjelbërimin me qëllim të përmirësimit të zonës ku qëndrojnë punonjësit çdo ditë, gjë që ka edhe një efekt vizual më të mirë dhe efekte pozitive në drejtim të reduktimit të përhapjes së aromave të pakëndshme.

Përveç këtyre operacioneve kyçe gjatë deponimit të mbetjeve, menaxhimi i Deponisë përfshinë masat dhe veprimet e mëposhtme:

- Mirëmbajtja e deponisë dhe rrugëve,
- Kontrolli i funksionimit të sistemit për aspirim, transport dhe djegjen e biogazit në eko-pishtar,
- Kontrolli i cilësisë së ujërave të kullimit,
- Kontrolli i cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit të burimeve pranë deponisë,
- Mbajtja e evidencës për sasinë dhe përbërjen e mbetjeve,
- Mbajtja e evidencës për sasinë e materialit mbulues në dispozicion dhe të përdorur,
- Angazhimi kohor i pajisjeve dhe të dhënat e mirëmbajtjes,
- Përcjelljen e shpenzimeve të deponimit,

- Sigurinë.

Orari i punës është i koordinuar me punën e ndërmarrjeve komunale që sjellin mbetje në atë mënyrë që në periudhën e dimrit mbetjet pranohen nga ora 8⁰⁰ – 20⁰⁰, dhe gjatë sezonit turistik veror nga ora 7⁰⁰ - 22⁰⁰, të gjitha 7 ditët e javës, si dhe gjatë festave shtetërore dhe fetare gjatë gjithë vitit.

Pas përfundimit të marrjes së mbetjeve, në Deponi është i pranishëm vetëm shërbimi i sigurisë.

VI OPERATIVNI PROGRAM POSLOVANJA ZA 2025. GODINU PROGRAMI OPERATIV I PUNËS PËR VITIN 2025

Programi i punës për vitin 2025 është planifikuar në përputhje me direktivat e BE-së, Ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Planin Shtetëror të Menaxhimit të Mbetjeve, dhe paraqet vazhdimësinë e deponimit cilësor të mbetjeve komunale në rajonin bregdetar.

Shërbimet do të ofrohen për shoqëritë komunale nga Tivari dhe Ulqini si komuna amë, në përputhje me kontratat e nënshkruara me ndërmarrjet komunale nga Budva, Tivati, Kotorri, Hemosani nga Tivari dhe palët e treta, subjektet afariste dhe personat fizikë në përputhje me Lejen e Integruar dhe lista e vlefshme e çmimeve të shërbimeve.

Sasitë e pritshme të mbetjeve për deponim dhe asgjësim sipas planit për vitin 2025 janë 102,000 tonë

Në vitin 2025 është planifikuar të pranohen mbetjet nga komunat amë të Tivarit dhe Ulqinit në sasinë prej përafërsisht 46.500 tonë, me çmim prej 10.00 € për ton, që vlen për komunat themeluese.


Pritet që mbetjet nga komunat e Budvës, Kotorrit dhe Tivatit të deponohet në sasinë prej 57.500 tonësh, me çmim prej 20.00 € për ton.

Një sasi prej 1000 tonësh pritet nga kompania private “Hemosan” nga Tivari, me çmim 20.00 € për ton.

Në bazë të sasive të deponuara për 7 muajt e vitit 2024, pritet që në vitin 2025 subjektet ekonomike të deponojnë 45 000 t, ndërsa individët 1 500 t mbetje jo komunale.

Tabela 1: Pasqyra e sasive të planifikuara të mbetjeve për deponim nga shfrytëzuesit

Shfrytëzuesi	Sasitë e mbetjeve për deponim (t)
shpk “Veprimtaritë Komunale” Tivar	28,000 t
shpk “Veprimtaritë Komunale” Ulqin	17,000 t
shpk “Komunalja” Budva	28,000 t
shpk “Komunalja Kotorr”	20,000 t
shpk “Komunalja” Tivat	8,500 t
shpk “Hemosan” Tivar	500 t
Sasia totale e planifikuar	102,000 t




Grafiku 4: Pasqyra e sasive të planifikuara të mbetjeve për deponim në vitin 2025 sipas shfrytëzuesit

Sipas parametrave të viteve të mëparshme, që kanë të bëjnë me dinamikën dhe sasinë e mbetjeve të deponuara në deponinë është hartuar plan mujor i deponimit të mbetjeve.

Tabela 2: pasqyra e sasive të planifikuara të mbetjeve komunale për deponim sipas muajve në vitin 2025

Muaji	Sasitë e planifikuara të mbetjeve (t)
Janar	6,300
Shkurt	5,800
Mars	6,500
Prill	7,000
Maj	8,800
Qershor	10,000
Korrik	13,500
Gusht	14,000
Shtator	9,500
Tetor	7,100
Nëntor	6,900
Dhjetor	6,600
GJITHSEJ:	102,000 t



Grafiku 5: Pasqyra e sasive të planifikuara të mbetjeve për deponim në vitin 2025 sipas muajve

VII RESURSET “MOZHURA” SHPK – PAJISJA MATERIALE DHE TEKNIKE

"Mozhura" sh.p.k posedon, përveç objekteve afariste, objekteve dhe tokës, pajisje dhe makineri të nevojshme për punën dhe funksionimin e Deponisë. Është planifikuar që në vitin 2025 të vazhdojë rritja e aseteve të kompanisë në atë mënyrë që do të ndajmë mjete të caktuara për blerjen e makinerive shtesë, mjeteve të punës, sigurimin e hapësirës për akomodimin e punonjësve dhe punimet në objektet ndërtimore në vetë deponinë.

	OBJEKTET	SASIA
I	Objekti afarist në deponi - sipërfaqja 100 m²	1
II	Zyret e administrates rruga Rista Lekiqi – sipërfaqja totale 123 m²	4
III	Objekte të tjera	1
1	Objekti montazh (punti i pranimi për MPK) S= 6 m ²	1
2	Peshorja për kamiona tip MJ 100A2N 18x3m 60t	1
3	Trafostacioni TS 10/0,4KV;1x630 /160 KVA	1
4	Vaska sanitare I	1
5	Vaska sanitare II	1
6	Vaska sanitare III	1
7	Vaska sanitare IV	1
8	Sistemi për ujërat rrjedhëse dhe kulluese nga bazeni 4 AB	1

9	Laguna- rezervoari akumulues V=700m ³	1
10	Rezervoari V=50m ³ për ujë teknik	2
11	Rruga, gjërsia 7 m (rruga e hyrjes dhe brenda deponisë)	1
12	Kanali mbitorësor AB për riparimin e mjeteve	1
13	Gardhi rrethues rreth tërë deponisë, gjatësia 2m	1
14	Lavazh për rrotat e automjeteve dhe hapësirës për punëtori	1
15	Buster stacioni për furnizim me ujë nga rezervoari	1
16	Objekti montazh për vendosjen e pompave S=6m ²	1
17	Rruga qasëse për MPK	1
	PAJISJET DHE MEKANIZIMI	KOLIÇINA
IV	Pajisjet	
1	Pompat për riqarkulimin e ujërave kulluese P=30KW	2
2	Pompat në lagunën për ujërat kulluese P=1,5KW	3
3	Pompat për larjen e automjeteve (larës me presion)	1
4	Gjeneratori SDMO Tipi J110K (110kVA,88kW)	1
5	Kompresori elektrik ABAC p _{max} =10bar	1
V	Mehanizacija	
1	Kompaktori Bomag BC 572 RB (2012)	1
2	Kompaktori STA Com 3000 (2004)	1
3	Buldozeri Shantui SD 13 (2011)	1
4	Eskavatori – ngarkues Terex TLB840 (2012)	1
5	Traktori MasFerguson me rimorkio dhe cisternë (2012)	1
6	Automjeti Shkoda Superb (2015)	1
7	Automjeti Skoda Octavia (2019)	1
8	Automjet mallrash Dacia Dokker (2015)	1
9	Grirëse për mbetjet e gjelbra (2017)	1
10	TMV Peugeot Rifter (2023)	1
11	Ekskavator zvarritës Hyundai 160LC-7A (2008)	1
12	Buldozeri CAT D6N XL (2018)	1
13	Kamion kiper IVECO Eurocargo 140 E 28 (2008)	1
14	Grirëse për mbetje të mëdha Arjes Impaktor 250 (2020)	1
15	Kompaktori Bomag BC 473 RB3 (2020)	1

Pajisjet e mira teknike kanë një rëndësi të madhe për një proces teknologjik cilësor të trajtimit të mbetjeve. Nevoja për këto mjete është veçanërisht e theksuar në muajt e verës, kur sasia e mbetjeve që deponohet rritet deri në tre herë në krahasim me periudhën e dimrit.

VIII PLANI FINANCIAR

-Mënyrat dhe burimet e financimit të ndërmarrjes

- Fondet e veta,
- Pjesëmarrja e komunave që deponojnë mbetje,
- Donacione dhe kredi nga fondet ndërkombëtare,
- Kreditë komerciale me bankat afariste,
- Mundësitë e bazuara në parimin e partneritetit publik-privat.

Është e rëndësishme të theksohet se "Mozhura" sh.p.k. pothuajse të gjitha mjetet që përdoren për financimin e shpenzimeve rrjedhëse i nxjerr nga të hyrat e veta, të cilat i mbledh nga shoqëritë komunale dhe palët e treta të cilave u ofron shërbime.

Numri rendor	ELEMENTET	Plani për vitin 2025 (€)
1	2	3
A	GJITHSEJ TË ARDHURAT	2.190.000,00 €
I	Të ardhurat nga veprimtaria	1.650.000,00 €
II	Të ardhurat financiare	- €
III	Të ardhura të tjera - të ardhura të shtyra dhe donacionet	540,000,00 €
B	SHPENZIMET GJITHSEJ (I+II+III)	2.129.536,00 €
I	Shpenzime nga veprimtaria (1.1+1.2+1.3+1.4+1.5+1.6+1.7)	2.099.536,00 €
1.1	Shpenzimet materiale	504.950,00 €
1.2	Shpenzimet e karburantit dhe enegjisë	170,000,00 €
1.3	Shpenzime e rrogave dhe të ardhurave tjera personale (1.3.1+1.3.2)	860.000,00 €
1.3.1	Rrogat bruto	780,000,00 €
1.3.2	Të ardhura të tjera	80.000,00 €
1.4	Shpenzimet e shërbimeve të prodhimit	110.450,00 €
1.5	Shpenzimet e amortizimit	302,156,00 €
1.6	Shpenzimet jomateriale	121.980,00 €
1.7	Shpenzime të tjera nga veprimtaria	30.000,00 €
II	Shpenzimet financiare (2.1+2.2)	- €
2.1	Shpenzimet e kamatave	- €
2.2	Shpenzime të tjera financiare	- €
III	Shpenzime joafariste dhe të jashtëzakonshme (3.1)	30,000,00 €
3.1	Rregullimin i çështjes banesore të punonjësve	30,000,00 €
IV	REZULTATI BRUTO I KOMPANISË (A-B)	60.464,00 €

Pasqyra tabelare e të ardhurave dhe shpenzimeve financiare për vitin 2025

A. Të ardhurat totale vjetore të planifikuara në vitin 2025

Baza për krijimin e të ardhurave totale vjetore është sasia e pritshme e mbetjeve që do të hidhet në deponinë në vitin **2025**.

A I

Meqenëse çmimi për shërbimet e deponimit të mbetjeve është 10 €/ton për kompanitë amë nga Tivari dhe Ulqini, dhe 20 €/ton për shfrytëzuesit e tjerë të shërbimeve, pa TVSH, të ardhurat totale të projektuara nga veprimtaria janë **1.650.000,00 €**.

A II

Të hyrat tjera përbëhen nga mjetet e shtyra në vlerë prej **230.000,00€** dhe donacionet nga fondet ndërkombëtare në vlerë prej **310.000,00€**. Në periudhën e kaluar është arritur bashkëpunim i mirë përmes ministrive përkatëse dhe Eko Fondit me partnerë ndërkombëtarë. Kompania ka aplikuar për grante për realizimin e të gjitha projekteve zhvillimore. Kjo praktikë do të vazhdojë si në vitin 2025 ashtu edhe në vitet në vijim të funksionimit.

Si një nga drejtimet e veprimit në të ardhmen do të ndërmerren aktivitete që do të çojnë në miratimin e vendimit, me të cilin do të veçohet zëri për deponim mbetjesh në faturat e mbetjeve, të cilat do të ngarkoheshin nga kompania jonë. Në këtë mënyrë do të lehtësohej operimi i ndërmarrjeve komunale të komunave themeluese të Tivarit dhe Ulqinit dhe në të njëjtën kohë, "Mozhura" do të mund të arrinte një arkëtim më të mirë të borxheve të saj, duke qenë që pagesa e detyrimit që këto dy shoqëri komunale kanë ndaj shoqërisë sonë janë në nivel të ulët në terma afatgjatë, d.m.th. që nga fillimi i funksionimit të deponisë.

B. Shpenzimet totale vjetore të planifikuara për vitin 2025

Shpenzimet janë planifikuar si afariste, financiare, jo afariste dhe të jashtëzakonshme gjithsej **2.095.536,00€** dhe i referohen:

I

Shpenzimet nga veprimtaria përfshijnë blerjen e materialeve dhe mallrave, shpenzimet e karburantit dhe energjisë, shpenzimet e rrogave dhe të ardhurave të tjera personale, shpenzimet e shërbimit të prodhimit, shpenzimet jomateriale dhe shpenzimet e tjera nga veprimtaria në total **2.065.536,00€**.

B 1.1

Shpenzimet për materiale dhe mallra të direkte arrijnë në gjithsej **504.950,00 €** dhe përfshijnë: mjetet dhe inventarin e vogël, blerjen e gomave për makineri ndërtimi, transporti dhe mjete motorike, furnizime për zyre, blerja e kompjuterëve dhe printerëve, blerja e produkteve higjienike, pjesëve për adaptimin e objekteve në deponi, pjesëve rezervë për pajisje elektromekanike, blerja e pajisjeve për mbrojtjen higjienike dhe teknike, pjesëve rezervë për makineri, sisteme vaditjeje, tuba dhe zorra për ujërat kulluese, blerja e materialeve dhe pajisjeve për sistemin e gazit të deponisë, prokurimi i pajisjeve për ruajtjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave si dhe video survejimit (sektori IT), mobilie për garderobë punëtorësh etj.

B. 1.2.

Shpenzimet për karburant dhe energji elektrike në vlerë prej **170.000,00 €**.

B 1.3

Shpenzimet e rrogave dhe të hyrave tjera personale janë planifikuar në vlerë prej **860.000,00€**, përfshirë rrogat bruto të punëtorëve dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, si dhe të hyrat tjera.

B 1.4

Shpenzimet e shërbimeve të prodhimit janë planifikuar në vlerë prej **110.450,00€**.

Këto shpenzime përfshijnë blerjet që do të përshkruhen më hollësisht në Planin e Prokurimit Publik dhe përmbajnë mirëmbajtjen e vaskave sanitare, mirëmbajtjen e zonës së deponisë (rrjeta mbrojtëse, rrugë, kanale rrethuese...), shpenzimet e marrjes me qira të makinerive të punës dhe kamionëve, mirëmbajtjen dhe shërbimin e Eko pishtarit, mirëmbajtjen dhe shërbimin e rrjetit të ujit dhe hidranteve, mirëmbajtjen dhe shërbimin e rrjetit të gazit të deponisë, etj.

B. 1.5

Shpenzimet e amortizimit janë vlerësuar në **302.156,00 €**, sipas vlerësimit të pronës së kompanisë.

B 1.6

Shpenzimet jomateriale janë planifikuar në vlerë prej **121.980,00€** dhe konsistojnë në: përgatitjen e dokumentacionit projektues për projektet e ndërtimit të vaskave sanitare, përgatitjen e dokumentacionit të tenderit për realizim, si dhe për projektin e shndërrimit të energjisë së biogazit në energji elektrike, hartimi i studimeve dhe raporteve, mbikëqyrje profesionale dhe shërbime konsulence, mirëmbajtje e faqeve të internetit, lloje të ndryshme të mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve, ekzaminime mjekësore periodike të punonjësve, shërbime shtypi, sigurimi i punonjësve dhe sigurimi i detyruar, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, sigurimi i pasurisë, trajnimi i punonjësve për punë të sigurt, auditim i llogarisë përfundimtare.

B 1.7

Shpenzimet tjera nga veprimtaria janë planifikuar në vlerë prej **30.000,00€**, ku përfshihen; monitorimi i parametrave mjedisor, punimeve gjeodezike etj.

III Shpenzimet financiare, jo afariste dhe të jashtëzakonshme janë planifikuar në vlerë prej **30.000,00€** dhe përfshijnë mjete për zgjidhjen e çështjeve banesore të punëtorëve.

Investimet e planifikuara:

Në vitin e ardhshëm, kompania parashikon përfundimin e ndërtimit të një impianti për konvertimin e biogazit në energji elektrike. Vlera e parashikuar e mjeteve të mbetura për realizimin e projektit është 560,000.00€.

Në vitin e ardhshëm do të intensifikohen ndjeshëm aktivitetet edhe për ndërtimin e vaskave të reja sanitare. Duke pasur parasysh se projekti përfshin ndërtimin e vaskave të reja dhe ndërtimin e qendrës për seleksionim dhe kompostim, si dhe blerjen e makinerive të reja, vlera e parashikuar për realizimin e këtij projekti është rreth 20 milionë euro. Duke qenë se kjo shumë i tejkalon ndjeshëm mundësitë financiare të Kompanisë, është bërë aplikimi në BERZH për marrjen e fondeve të nevojshme. Duke qenë se ky është projekt i një rëndësie të jashtëzakonshme, jo vetëm për kompaninë tonë, por edhe për komunën e Tivarit dhe Ulqinit,

pra gjithë rajonin bregdetar, kompania do të ndërmarrë të gjitha veprimet në dispozicion edhe në rast të një rezultati negativ kur është fjala për financimin e BERZH-it për të realizuar projektin e zgjerimit të deponisë, duke u mbështetur në përkrahjen maksimale të komunave themeluese, si dhe të Ministrisë së Ekologjisë, Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Zhvillimit të Veriut dhe Qeverisë së Malit të Zi.

Në vitin 2025, është planifikuar të blihet një kamion kiper, si dhe një ekskavator zvarritës. Kompania do të financojë blerjen e këtyre makinerive nga fondet e veta.

IV Kompania planifikon fitim në vitin 2025 në vlerë prej 60.464,00€

IX DREJTIMET E VEPRIMIT NË TË ARDHMEN - MISIONI, VIZIONI DHE QELLIMET

Puna e kompanisë "Mozhura" sh.p.k. ka të bëjë në radhë të parë me mbrojtjen e mjedisit dhe hapësirës me deponim të duhur dhe të kontrolluar të mbetjeve, duke respektuar të gjitha rregulloret që janë të harmonizuara me ligjet dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e mjedisit.

Menaxhmenti i kompanisë dhe të gjithë punonjësit kanë bërë përpjekje të konsiderueshme në vitet e kaluara për ta mbajtur deponinë në funksion dhe zhvillim në duke synuar procese pune më cilësore dhe deponim më të mirë të mbetjeve.

Gjatë viteve të kaluara është arritur bashkëpunim jashtëzakonisht i mirë me fondet vendase dhe të huaja sa i përket mbështetjes për realizimin e projekteve. Kompania aplikoi me disa projekte, disa prej të cilave janë në fazën përfundimtare të zbatimit dhe presim të përfundojnë në fund të vitit 2024 ose gjatë vitit 2025. Para së gjithash presim donacion të makinës së kombinuar përmes Komunës së Ulqinit dhe ndërtimin e centralit, për të cilin 50% e mjeteve do të sigurohen nga CMSR. Fondet që kompania duhet të fitojë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar janë shumë domethënëse dhe sigurojnë zhvillimin e mëtejshëm të deponisë së Mozhurës. Gjatë vitit 2025 presim të realizohet bashkëpunimi me BERZH-in, përmes të cilit duhet të gjenerohen mbi 20 milionë euro, pjesë e të cilave do të ishte GRANT, për realizimin e projekteve zhvillimore të Kompanisë.

Për shkak të rritjes së çmimeve të derivateve të naftës në treg, dhe duke marrë parasysh faktin se kostot më të mëdha për punën në Deponisë janë pikërisht marrja me qira e makinerive të rënda - kompaktorë, ekskavatorë, buldozerë e të tjera, si dhe rritja e çmimeve të gjitha shërbimeve dhe mallrave dhe projektet zhvillimore tashmë të filluara, do të ishte e nevojshme të mendohej për rritjen e çmimeve për shërbimet e deponimit të mbetjeve në një periudhë të ardhshme gjatë vitit 2025. Duke pasur parasysh faktin se kompania jonë që deponon 1 ton mbeturina kushton rreth 14.00€, është e pajustificuar ekonomikisht të operohet sipas çmimoreve aktuale, e cila nuk ka ndryshuar që nga fillimi i funksionimit të Deponisë.

Për përkujtim, në deponinë "Mozhura" çmimi i deponimit të mbetjeve për komunat themeluese është 10.00€/t, ndërsa për komunat tjera dhe palët e treta 20.00€/t. Për hir të krahasimit, çmimi zyrtar për një ton mbetje të deponuara në deponinë "Livade" në Podgoricë është 36.00 euro, ndërsa kjo shifër është dukshëm më e lartë në vendet fqinje të BE-së.

Me deponimin dhe trajtimin e duhur të mbetjeve, të cilat deponohen në deponinë "Mozhura",

anulohen pasojat e mundshme të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës përreth, të gjitha në përputhje me vlerat referuese të parashikuara në ligj.

Në vitin 2025 do të vihet në punë impianti për prodhimin e energjisë elektrike nga mbetjet, vlera e të cilit është rreth 1.4 milionë euro.

Deponia e Mozhurës do të jetë e para në këtë pjesë të Ballkanit që do të ketë një central për prodhimin e energjisë elektrike nga mbeturinat.

Njohja me metodat dhe teknologjitë e punës së Deponive të tjera më të zhvilluara paraqet një nxitje shtesë për zhvillimin e mëtejshëm, aplikimin e metodave të reja dhe përmirësimin e metodave ekzistuese të punës.

Misioni afarist i kompanisë në vitin 2025 dhe në vitet në vijim do të jetë mbrojtja e mjedisit dhe krijimi i mjedisi jetese më të shëndetshëm, përmes trajtimit bashkëkohor ekologjik të mbetjeve dhe zhvillimit në të ardhmen përmes zbatimit të aktiviteteve të reja dhe mbi të gjitha, përzgjedhjes korrekte të mbetjeve. dhe prodhimin e energjisë elektrike nga mbeturinat.

Në vitin 2025, menaxhmenti i kompanisë planifikon të vazhdojë të avancojë njohuritë e punonjësve të saj.

Nëse mbahen tubime dhe panairë lokale dhe ndërkombëtare me temën e ekologjisë, mbrojtjen e mjedisit, trajtimin e mbetjeve, Mozhura do të marrë pjesë për të avancuar njohuritë e punonjësve, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së punës dhe funksionimit të Deponisë në vitet e ardhshme.

Presim që projektet e planifikuara të përfshihen në Planin Hapësinor të Malit të Zi deri në vitin 2040 dhe në Planin Urbanistiko-Hapësinor të Tivarit në përputhje me sugjerimet që Kompania jonë i ka dorëzuar me kohë përpunuesve të këtyre dokumenteve.

Gjatë vitit 2024 po punohet në mënyrë aktive në përgatitjen e dokumentacionit për realizimin e projekteve të ardhshme.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka marrë leje për të përpunuar gomat, mbetjet e ndërtimit dhe mbetjet nga prishjet. Impiantet për përpunimin e mbetjeve të ndërtimit dhe mbetjeve të prishjes filluan të funksionojnë në maj 2024.

Theks i veçantë do t'i kushtohet përgatitjes së dokumentacionit projektues dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet ndërkombëtare me qëllim të marrjes së mbështetjes financiare për zhvillimin e mëtejshëm të kompanisë. Kompania do të aplikojë në mënyrë direkte ose indirekte në fonde të ndryshme të huaja dhe vendase, për të ofruar mbështetje për zhvillim të mëtejshëm.

Qëllimi i veprimtarisë afariste të Mozhurës është vazhdimi i trajtimit të mbetjeve me cilësi të lartë në vitin 2025. Zgjerimi i kapaciteteve dhe ndërtimi i objekteve të reja sanitare mbetet një projekt prioritar, për të zgjidhur problemin e depozitimit të mbetjeve në rajonin bregdetar për 8-10 vitet e ardhshme.

X PËRFUNDIM

Në vitin 2025, kompania do të vazhdojë me detyrat e besuara në lidhje me trajtimin e duhur, sanitar dhe mbi të gjitha ekologjik të deponimit të mbetjeve komunale, me deponim adekuat në vaska sanitare.

Plani i prokurimit publik për vitin 2025 përcakton dhe sistemon qartë të gjitha nevojat e Kompanisë për operim të suksesshëm në vitin 2025.

Theksi do të vihet në zhvillimin e mëtejshëm dhe të përshpejtuar të kapaciteteve të kompanisë, zbatimin e projekteve të nisura për mbrojtjen e mjedisit dhe vazhdimin e funksionimit të suksesshëm. Do të ndërmerren të gjithë hapat në lidhje me realizimin e këtyre projekteve.

Përveç ambicieve të menaxhmentit që kanë të bëjnë me zhvillimin, aktivitetet do të synojnë edhe rregullimin e borxhit nga kompanitë themeluese, duke vazhduar bashkëpunimin e vazhdueshëm me Ministrinë kompetente dhe Agjencinë për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit, Eko Fondin dhe organizata të tjera qeveritare dhe joqeveritare, partnerë të huaj, qytetarë dhe të gjithë subjekteve dhe individëve të interesuar, qëllimi i të cilëve është ndërgjegjësimi për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.


Drejtori ekzekutiv
Senad Arabeloviq